

Fondi Shqiptar i Zhvillimit po studion mundësinë për shndërrimin afatgjatë të institucionit në një institucion financiar që do t'u japë mundësinë e marrjes së kredive për investime Njësive të Qeverisjes Vendore

Nga Ersuin SHEHU

**K**a institucione që dinë ta shpallin punën e tyre me buji, por ka të tjerë që njihen pak, megjithëse kryejnë volum të rëndësishëm pune. Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH) është një agjenci e cila kryen aktivitetin e saj me synim nxitjen dhe mbështetjen e pushtetit lokal drejt një zhvillimi të qëndrueshëm dhe deri më sot ka administruar 1593 projekte, me një vlerë investimesh që për 6 vitet e fundit prek vlerën e 126 milion dollarëve. Fondi është krijuar që në vitin 1993 si agjenci autonome zbatuese e "Projektit të Lehtësimit të Varfërisë në Zonat Rurale", projekt i themeluar nga Banka Botërore në bashkëpunim me Qeverinë Shqiptare dhe përfshinte edhe komponentë të huadhënies. FSHZH është profilizuar kryesisht në mbështetjen dhe forcimin e pushtetit lokal, si dhe të zhvillimit të komuniteteve, nëpërmjet rehabilitimit të infrastrukturës parësore. Veprimtaria e deritanishme e FSHZH-së është orientuar në përmirësimin e infrastrukturës bazë të komuniteteve lokale, ngritjen e kapaciteteve të Njësive të Qeverisjes Vendore dhe komuniteteve dhe mbështetjen me financime të programeve sektoriale të zhvillimit të Njësive të Qeverisjes Vendore. Fondi Shqiptar i Zhvillimit raporton se deri më sot ka administruar dhe realizuar 1593 nën-projekte të infrastrukturës, që kanë prekur kushtet e jetesës së 2.85 milion përfituesve. Nga këto, 857 janë rrugë, 280 ujësjellësa, 116 shkolla, 70 qendra

shëndetësore, 63 sisteme kullimi, 47 ura, 17 tregje, 34 rrjete kanalizimesh, 38 ndërtesa publike, 71 objekte të tjera. Numri mesatar i nën-projekteve të përfituara për çdo Njësi të Qeverisjes Vendore është katër të tilla. Sipas drejtorit ekzekutiv, z.Benet Beci, FSHZH ka qënë shumë e angazhuar gjithashtu në ngritjen e kapaciteteve të partnerëve lokalë. Në përputhje me reformën e decentralizimit mjaft kompetenca kanë kaluar (së bashku me trajnimet përkatëse) nga FSHZH-ja drejt Njësive të Qeverisjes Vendore, të tilla si vendimmarrja për projektet prioritare, kontraktimi i projektuesit, organizmi i procesit të prokurimit, mbikqyrja e punimeve e marrja e tyre në dorëzim. FSHZH aktualisht po zbaton rreth 50 projekte të infrastrukturës në terren. Këto projekte janë mbështetur nga Qeveria Shqiptare dhe Banka Botërore në kuadër të projektit "Punët me komunitetin II". "Kemi negociuar dhe është miratuar - thotë z.Beci - një kredi prej 10 milion eurosh nga Banka për Zhvillim e Këshillit të Evropës për financime në infrastrukturë rurale. Këto investime do të mbështeten në prioritetet kryesore të Planeve Strategjike të Zhvillimit për rreth 10-12 komuna në vend. Financimi parashikohet të jetë nga 600 mijë deri në 1 milion euro për komunë." Ndërkohë, qysh në muajt në vijim do të bëhet efektivi projekti i ndërtimit të ujësjellësve ruralë. Ky projekt do të financohet me mbështetjen e Bankës Gjermane KfW me një vlerë prej 10 milion eurosh. "Synimi - thotë z.Beci - është



FOTO: BLENDAR HASIMI

ndërtimi i ujësjellësve ruralë në fshatrat e komunat e varfra të vendit. Fondi Shqiptar i Zhvillimit është në diskutime edhe për një projekt të financiar nga Banka Islamike për Zhvillim me vlerë rreth 10 milion USD, për zhvillimin e zonave rurale të Qarqeve Shkodër e Lezhë. Parashikohet që diskutimet të mbyllën së shpejti dhe që zbatimi i projektit të fillojë vitin e ardhshëm.

## DIMENSION I RI PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM

Intervistë me z.Benet Beci, drejtor ekzekutiv i Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

**Ku dallon FSHZH-ja nga dikasteret dhe entet e tjera që trajtojnë zhvillimin e infrastrukturës? Cilat janë veçoritë karakteristike të agjencisë suaj?**

Fondi Shqiptar i Zhvillimit gjatë punës së tij, dhe sidomos falë asistencës së përhershme të partnerëve të huaj, në veçanti Bankës Botërore, ka formësuar një sërë standardesh në punën e tij, të cilat e bëjnë të dallohet nga agjenci të tjera që


veprojnë në fushën e infrastrukturës. Dallimi i parë konsiston në identifikimin e nevojave dhe në planifikimin e ndërhyrjeve. Fondi shqiptar garanton dhe ka standardizuar pjesëmarrjen e komunitetit në të gjitha proceset e vendimmarrjes që lidhen me investimin. Gjithashtu përzgjedhja e projekteve kryhet nga vetë banorët, dhe kalon më pas në një sërë filtrash që bazohen tek shkalla e përmirësimeve që do të sjellë investimi në gjendjen ekonomike, sociale, varfërinë, mjedisin, si dhe në raportet e kostos me përfituesit, apo kostos me mirëmbajtjen. Komuniteti është i përfaqësuar gjatë gjithë ciklit të zbatimit të projektit në terren nëpërmjet një grupi të përzgjedhur prej tyre, grupi i këshillimit dhe i ndjekjes. Komuniteti në projektet tona është edhe bashkëfinancues me një shumë që shkon në 10% të gjithë investimit. Kjo jo vetëm

krijon ndjenjën e pronësisë ndaj objektit që realizohet, por edhe mundëson mirëmbajtjen e tij në vazhdim. Duke iu rikthyer pyetjes suaj mbi dallimet, mendoj se një ndër veçantitë e Fondit është se ne nuk çojmë vetëm një investim në komunitet dhe garantojmë që të bëhet me cilësi, por ne i kushtojmë rëndësi edhe rritjes së kapaciteteve të vetë pushtetit vendor duke ndikuar jo vetëm në trajnimin e tyre për ndjekjen e procedurave tona, por edhe në sigurimin e një funksionimi dhe mirëmbajtjeje të mirë pasi ky objekt të jetë marrë në dorëzim nga ana e pushtetit lokal. Ndërhyrjet tona bëhen në bazë të një strategjie, e cila synon në vetvete jo thjesht dhënien e një ndihme atyre komuniteteve që kanë nevojë, por garantimin e një zhvillimi nëpërmjet investimit. Kjo kërkon që ne të kemi informacion të hollësishëm detajuar për

# ATA QË PUNOJNË



**Vlera e investimeve të realizuara nga FSHZH (million USD)**



**Mbi ç'baza duhet mbështetur zhvillimi urban dhe rural i vendit tonë? Cilat janë perspektivat për të pasur një zhvillim të qëndrueshëm?**

Vitet e fundit janë ndërtuar apo rishikuar strategji ndërsektoriale mjaft të rëndësishme për zhvillimin e vendit, siç janë strategjia e Decentralizimit, Strategjia e Zhvillimit Rajonal apo Strategjia e Zhvillimit Rural. Të gjitha këto strategji janë ndërtuar duke marrë parasysh edhe përvojat e mira të vendeve të ngjashme dhe realitetin e shoqërisë sonë. Si gjithmonë, sfida e vërtetë mbetet realizimi në praktikë i këtyre strategjive. Bazuar në përvojën tonë të gjatë të punës me Njësitë e Qeverisjes Vendore do të donim të vinim në dukje disa çështje që në këndvështrimin tonë janë të domosdoshme për zhvillimin e qëndrueshëm rural e urban.

Së pari, Bashkitë e Komunitat duhet të kenë një vizion të qartë zhvillimi të bazuar në karakteristikat lokale, në shfrytëzimin sa më racional të burimeve natyrore e njerëzore si dhe të mundësive realiste për zhvillimin.

Së dyti, të zgjedhurit e zyrtarët lokalë duhet të bëjnë përpjekje për ndërtimin e mekanizmave demokratikë për përfshirjen e komunitetit në përgjithësi dhe grupeve specifike të interesit në marrjen e vendimeve dhe rritjen e transparencës për të gjithë aktivitetin e tyre.

Së treti, duhet fuqizuar me shpejtësi kontrolli mbi territorin. Përveç efekteve që janë evidente për të gjithë, mungesa e kontrollit mbi ndërtimet apo përdorimin e tokës e bën mjaft të kushtueshëm ofrimin e infrastrukturës inxhinierike e nëntokësore për të gjitha këto objekte. Së katërti, Bashkitë e Komunitat duhet të mendojnë më tepër për krijimin e ambientit të përshtatshëm për zhvillimin e biznesit në territorin e tyre, ofrimin e mundësive për punësim e trajnim, veçanërisht për të rinjtë.

**Si duhet parë roli i FSHZH në një perspektivë të afërt?**

Aktiviteti i FSHZH-së sot, përveç ndjekjes së investimeve në infrastrukturë, në dy vitet e fundit është përqendruar veçanërisht për transformimin e FSHZH-së në një institucion bashkëkohor. Kështu, vëmendje i është kushtuar së pari përmirësimit të menaxhimit, është kryer

një riorganizim strukturor me synim rritjen e rezultateve të personelit, planifikimit, miradministrimit, transparencës dhe komunikimit me publikun dhe partnerët. Po punojmë shumë në drejtim të ngritjes së një institucioni të qëndrueshëm që të jetë përherë e më tepër një partner serioz dhe i besueshëm i donatorëve, Qeverisë qendrore e lokale.

Këto përmirësime janë vlerësuar dhe mbështetur nga të gjithë partnerët tanë me të cilët po punojmë për realizimin e projekteve në vazhdim e fillimin e projekteve të reja.

Përsa u përket drejtimeve kryesore në të cilat Fondi do të lëvizë në të ardhmen mund të themi se një nga komponentët e rinj që FSHZH-ja, në bashkëpunim me Bankën Botërore po ofron dhe promovon, janë mbështetja e njësive të Qeverisjes Vendore në hartimin e Planeve të Zhvillimit Lokal. Këto plane janë shumë dimensionale dhe përfshijnë brenda tyre zhvillimin ekonomik, social, përmirësimin e infrastrukturës e përmirësimin e qeverisjes vendore. Komponenti i planifikimit para investimeve do të jetë një nga tiparet e punës së FSHZH-së në të ardhmen e afërt. Në bazë të kësaj të njëjtte pune qëndron parimi se planifikimi është një mjet i fuqishëm që orienton investimet drejt zhvillimit social-ekonomik të komuniteteve.

Një tjetër aspekt ku mendojmë të shtrijmë përpjekjet tona është qëndrueshmëria e investimeve. Për të gjithë që punojnë me qeverisjen vendore në Shqipëri është e qartë se një nga sfidat kryesore me të cilat përballen komunitat e bashkitë është mirëmbajtja e funksionimi me efektivitet i investimeve të kryera. Njësitë e Qeverisjes Vendore në Shqipëri shpesh vuajnë mungesën e burimeve financiare e njerëzore për të ngritur sisteme të qëndrueshme për mirëmbajtjen e funksionimin e investimeve në infrastrukturën lokale siç janë p.sh rrugët e ujësjellësit.

Aktualisht jemi në fazën e studimit të mundësive për shndërrimin afatgjatë të institucionit në një institucion financiar që do t'u japë mundësinë e marrjes së kredive për investime Njësive të Qeverisjes Vendore. Institucionet kredidhënëse për bashkitë me pronësi publike janë një traditë shumë e gjatë dhe e suksesshme në vendet perëndimore. Këto institucione janë ngritur e po funksionojnë me sukses në dhjetëvjeçarët e fundit edhe në vendet në zhvillim, si vendet e Europës Lindore apo në Amerikën Latine.

Nga njëra anë, kjo skemë ka të mirën që gjeneron mundësi të vazhdueshme për investime nga kthimi i kredive pavarësisht nga kreditë apo donacionet e institucioneve të tjera. Nga ana tjetër, rezultatet e këtyre institucioneve në vende të tjera tregojnë se mundësia e marrjes së kredive për investimeve çliron buxhetet lokale nga barra shumë e rëndë e investimeve (të cilat realizohen me anë të kredive), duke dhënë mundësinë për përdorimin e pjesës kryesore të buxhetit në funksion të rritjes së sasisë e cilësisë së shërbimeve komunale e bashkiake. ■

nevojat e komunitetit, burimet e tyre si financiare ashtu edhe njerëzore, si dhe të njohim tendencën e tyre të zhvillimit. E gjithë kjo arrihet nëpërmjet një rrjeti të organizuar specialistësh që ne kemi në terren, si edhe të një sistemi të informatizuar që kemi ngritur gjatë këtyre viteve.

**Si janë ndërtuar marrëdhëniet tuaja me organet e pushtetit qendror dhe vendor, si dhe me donatorët?**

FSHZH-ja drejtohet nga një Bord Drejtues, i cili në përbërje të tij ka anëtarë të qeverisë, si edhe përfaqësues të pushtetit lokal. Bordi kryesohet nga Zëvendëskryeministri z.Gazmend Oketa. Qeveria Shqiptare, nëpërmjet përfaqësimit të saj në bord, në nivelet më të larta madje, garanton jo vetëm një mbështetje të FSHZH-së në përmbushjen e detyrave të saj, por gjithashtu siguron një shtrirje të zbatimit të politikave sektoriale dhe strategjive kombëtare edhe në këtë fushë. Raportet tona me këta aktorë të rëndësishëm që ju përmendët janë raporte të një partneriteti të qëndrueshëm. Ndër donatorët mund të përmendim Bankën Botërore, Komunitetin Evropian, KFW-në Gjermane, Qeveritë e Italisë, Francës, Zvicrës, ILO, IFAD, UNDP, Banka për Zhvillim e Këshillit të Evropës, Banka Islamike për Zhvillim etj.

# NË "NË HIJE"